

URDHËR
Nr. 193, datë 3.5.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E PORTIT TË
PËRPUNIMIT TË LËNDËVE DJEGËSE PËR SHOQËRINË KONCESIONARE
“PORTI MBM” NË ROMANO PORT DURRËS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 401, germa “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare ‘Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947’”, dhe ligjit nr. 9594, datë 27.7.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare ‘Për parandalimin e ndotjeve nga anijet 1973–1978 (MARPOL 73/78)’”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për funksionimin e portit të përpunimit të lëndëve djegëse për shoqërinë koncesionare “Porti MBM” në Romano Port Durrës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
 2. Ngarkohet “Porti MBM”, Romano Port Durrës për zbatimin e këtij urdhri.
 3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku